REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 779/22
Data/Datum. 03.04.23
PRISHTINË - PRIŠTINA

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

**PSH. Nr. 779/22**

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga, Agon Ramadani Kryetar, Kimete Gashi dhe Vedat Poterqoi, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik, OE "Aritech" me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me pajisje të IT-së" me numër të prokurimit: 214-22-12230-5-5-8-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), më datën 03.04.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

I. Aprovohet si e bazuar, ankesa e datës 19.12.2022, e OE "Aritech"sh.p.k me seli në Prishtinë, nr.779/22, e parashtruar kundër Vendimit të AK, të datës 01.12.2022 lidhur me aktivitetin e prokurimit : "Furnizim me pajisje të IT-së" me numër të prokurimit 214-22-12230-5-5-8-1, kurse Vendimi i cituar si më sipër i AK Anulohet, ndërsa aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.

II. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj me shkrim OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, të precizuar si në paragrafin paraprak të dispozitivit të këtij vendimi, në të kundërtën OSHP ka të drejtë të ndërmarr masa për mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

III. Lejohet kthimi i mjeteve të deponuara me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse Ankuesi ka të dejtë që në afat prej 60 (ditëve) të parashtroj kërkesë për kthimin e mjeteve, në të kundërtën të njëjtat konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP.

## A r s y e t i m

*- Faktet dhe rrethanat procedurale –*

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 19.12.2022,ka pranuar ankesë nga OE "Aritech"sh.p.k për aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me pajisje të IT-së", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Ministria e Punëve të Brendshme, ankesë kjo e protokolluar nga OSHP me numër të protokollit 779/2022.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë mini-tenderim, vlerë të madhe, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 306,730.00 €.

Për aktivitetin prokurimit në fjalë Autoriteti Kontraktues Ministria e Punëve të Brendshme me datën 01.12.2022,ka publikuar njoftim mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, ku është rekomanduar për kontratë OE "Botek" sh.p.k, me seli në Prishtinë.

Me datë 06.12.2022,OE ankues ka bërë kërkesë për rishqyrtim, me datë 08.12.2022 AK-Ministria e Punëve të Brendshme, e refuzon si të pa pabazuar kërkesën për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik "Botek" sh.p.k. përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

***- Vlerësimi dhe administrimi i provave –***

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me ketë, me 05.01.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa e OE ankues "Aritech" sh.p.k me seli në Prishtinë të refuzohet si e pa bazuar,

- të mbetet në fuqi vendimi i AK i datës 01.12.2022, (*vendim për dhënie të kontratës*).

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të lëndës, duke qenë se në ekspertizën e lartcekur eksperti shqyrtues profesional i prokurimit ka deklaruar (citim): "*...nuk kemi mundur ti gjejmë ofertat lidhur me këtë procedurë prokurimi dhe i gjithë raporti ekspertizës mbështetet në provat dhe dokumentet e ofruara nga OE ankues..*" si dhe duke qenë se çështja kontestuese ka qenë plotësisht e bazuar në pretendime ankimore të natyrës teknike, paneli ka konstatuar se qëndron nevoja që të kërkohet super-ekspertizë teknike, andaj nga administrata e OSHP-së është kërkuar të caktohet një ekspert nga fusha e teknologjisë informative (TI/IT) në mënyrë që të shqyrtohen pretendimet ankimore të kësaj natyre nga një ekspert teknik.

Me 30.03.2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar raportin e ekspertizës me të cilin ka prezantuar të gjeturat si në vijim.

*-Të gjeturat e ekspertit teknik*

**Përgjigje në pretendimin ankimor** – OE ankues pretendon se nuk qëndron arsyetimi i eliminimit, i precizuar nga AK në njoftimin mbi vendimin e AK-së dhe konfirmuar në vendimin për kërkesën për rishqyrtim. Konkretisht pretendimi ankimor ka të bëjë arsyetimin e eliminimit që lidhet me gjeneratën e procesorit të kompjuterëve.

Aktiviteti i prokurimit është iniciuar në kuadër të Marrëveshjes së Përgjithshme Kornizë, me numër të prokurimit UA/2016-19-9628-1-1-1, të nënshkruar në mes të Autoritetit Qendror të Prokurimit (AQP) dhe gjashtëmbëdhjetë (16) OE-ve. Në marrëveshje, tek specifikimi teknik për kompjuterët dhe llaptop-ët shënohet se kërkohet gjenerata e parafundit në datën e publikimit të njoftimit për kontratë.

Publikimi i njoftimit për kontratë për këtë aktivitet është bërë me datë 02.11.2022. Në tenderin e dorëzuar nga OE ankues janë prezantuar dokumenti me specifikimin teknik të ofertuar dhe broshurat e produkteve të ofertuara. Në këto dokumente specifikohet se OE ka ofertuar me produktet e prodhuesit HP, ndërsa gjenerata e procesorëve për kompjuter dhe llaptop është si vijon: Artikulli 1- është ofertuar procesor Core i7 - 11700F (gjeneratës 11), Artikulli 2- është ofertuar procesor Intel Core i5- 12400 (gjeneratës 12), Artikulli 4- është ofertuar procesor Intel Core i5- 1135G7 (gjeneratës 11), Artikulli 5 - është ofertuar procesor Intel Core i7- 12700 (gjeneratës 12).

OE ankues ka prezantuar edhe dy prova. Emailin nga distributori ITD Prishtinë Sh.p.k, ku distributori e njofton AK-në me datë 06.12.2022 se ende nuk ka në dispozicion kompjuterë dhe llaptop me procesor të gjeneratës 13. Poashtu është bashkangjitur edhe shkresa e prodhuesit Lenovo, e dërguar me datë 08.12.2022 ku thuhet se Lenovo nuk ka ende produkte të disponueshme me gjeneratën e 13-të të procesorëve Intel dhe se Lenovo po planifikon të prezantojë gjeneratën e re të procesorëve Intel në Q2 (tremujorin e dytë) të vitit 2023.

Eksperti teknik ka ekzaminuar edhe ofertat e shtatë (7) OE-ve tjerë që kanë ofertuar në këtë aktivitet të prokurimit. Në tenderin e dorëzuar nga OE Novus është dorëzuar edhe një shkresë nga prodhuesi Dell në lidhje me gjeneratën e procesorëve të kompjuterëve dhe llaptop-ëve. Në këtë shkresë thuhet se gjenerata aktuale Optiplex bazohet në gjeneratën e 12-të të procesorëve Intel Alder Lake, dhe se gjenerata e ardhshme e 13-të e CPU-ve Intel do të jetë Raptor Lake dhe janë planifikuar të lëshohen në treg diku në mars ose prill të vitit të ardhshëm (2023). Më tej thuhet se të gjithë konkurrentët kanë ende sisteme të bazuara në gjeneratën e 12-të, sikurse ne, kështu që tregu aktualisht është në këtë gjeneratë në përgjithësi.

Andaj, duke u bazuar në faktet dhe argumentet e sipërpërmendura, Eksperti Teknik sqaron se është e qartë dhe evidente se në vitin 2022 kompjuterët dhe llaptop-ët e ofruar në treg me gjeneratën 12 janë pajisjet me gjeneratën e fundit të procesorëve në dispozicion, të cilat mund të porositeshin dhe bliheshin në periudhën e njoftimit për kontratë dhe dorëzimit të ofertave, sikurse konstatohet nga prodhuesit (Dell dhe Lenovo). Në kuptimin e kërkesave për gjeneratë të procesorëve të këtyre pajisjeve, për vitin 2022 gjenerata e parafundit konsiderohet gjenerata e 11 e procesorëve të Intel. Rrjedhimisht pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar.

## MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES DHE TEKNIK

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Teknik i propozon Panelit Shqyrtues që ankesat e OE ankues të aprovohet si e bazuara. Më tej rekomandohet që të anulohet vendimi i AK-së dhe aktiviteti të kthehet në rivlerësim.

*-Seanca dëgjimore*

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtresat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

- *Konstatimet e panelit shqyrtues*

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues profesional dhe atij teknik, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar, konstaton që ankesa OE ankues "Aritech" sh.p.k me seli në Prishtinë klasifikohet si e bazuar

Paneli shqyrtues konstaton se si çështje përcaktuese për të arritur deri tek vendim-marrja sikurse në dispozitiv ka qenë pretendimi ankimor i OE ankues se kompjuterët dhe llap-top-ët e gjeneratës së 13 të procesorëve nuk kanë ekzistuar në treg, lidhur me këtë AK ka refuzuar ofertën e OE ankues me arsyetimin se në dy prej pozicioneve të ofruara nuk ka ofertuar me procesorë së gjeneratës së parafundit që sipas AK-së është dashur të jetë gjenerata e 12 me qenë se gjenerata e 13 e procesorëve ekziston në treg që nga data 20.10.2022 (gjithashtu ka paraqitur dy vegëza nga Intel), ndërsa OE ankues ka kundërshtuar këtë në kërkesën për rishqyrtim të cilën AK e ka refuzuar duke bashkangjitur faktet dhe argumentet (komunikime nga një distributor dhe prodhuesi Lenovo) se me të cilat është thënë që procesorët e gjeneratës së 13 nuk janë të inkorporuar në pajisjet e tyre dhe se pritet që gjatë vitit 2023 të dilet me produkte (llap-topë) me procesorë të gjeneratës së 13.

Pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore si objekt i ankesës, PSH konstaton se pretendimet ankimore të OE ankues i klasifikon si të bazuara, duke u mbështetur në ekspertizën e ekspertit teknik, kështu që arsyetimet e tij llogariten si arsyetime të PSH.

Lidhur me arsyetimet e AK-së se të gjithë OE kanë ofertuar ,e procesorë të gjeneratës së 12, PSH konstaton se qëndron, por kjo nënkupton se ata kanë ofertuar me pajisje të gjeneratës së fundit, e jo të parafundit, për të dëshmuar këtë, OE ankues ka prezentuar poashtu dy deklarata, një nga një distributor i pajisjeve kompjuterike, me të cilën është deklaruar se në treg nuk ka llaptopë të gjeneratës së 13, e poashtu OE ankues ka paraqitur shkresën nga Lenovo në bazë të së cilës thuhet

se llaptopët me gjeneratë të 13 të procesorëve pritet që të dalin në treg në TM2 2023, përveç tjerash, eksperti ka evidentuar se në përmbajtje të ofertave tjera poashtu ka hasur në një shkresë nga Dell, të cilët kanë deklaruar se llaptopët me gjeneratë të 13 të procesorëve planifikohen në mars/prill të vitit 2023, andaj duke konsideruar këto fakte, argumente si dhe sipas hulumtimeve të thjeshta në internet, rezulton se në kohën e njoftimit për kontratë (nëntor 2022), nuk ka pasur në treg llaptopë të gjeneratës së 13, andaj rrjedhimisht nuk mund të konsiderohet gjenerata 12 sikurse ajo e parafundit, por e fundit, kështu që rrjedhimisht gjenerata e 11 del të jetë ajo e parafundit në treg, kështu që OE ankues ka plotësuar kriterin relevant sikurse është kërkuar në DT, e poashtu këtë e dëshmon fakti se asnjë nga operatorët nuk ka ofertuar me gjeneratë të 13 të procesorëve,

Andaj përfundimisht, arsyetimi i AK-së se procesori i gjeneratës së 13 është lansuar në treg me 20.10.2022 sipas PSH qëndron, por përgjatë vitit 2022 nuk ka pasur llaptopë me këtë gjeneratë të procesorëve, kështu që pretendimi i OE ankues se në këtë aktivitet nuk është kërkuar vetëm procesor, por llaptop dhe kompjuterë klasifikohet si i bazuar, kështu që paneli konstaton se ankesa e OE ankues është e bazuar, si dhe arsyetimi i AK-së lidhur me bazën eliminuese, përveç që konsiderohet në kundërshtim me tiparet e LPP-së, që janë diskriminimi dhe kursimi i parasë publike, këtë AK poashtu nuk e ka specifikuar apo sqaruar para ofertimit të OE-ve pjesëmarrës.

Paneli shqyrtues me marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli Shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues
Agon Ramadani

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:
1x1 AK Ministria e Punëve të Brendshme
1x1 OE "Aritech" me seli në Prishtinë
1x1 Arkivës së OSHP-së;
1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.